

## TÜV NORD CERT

Certifikimi ne Standartet

ISCC PLUS – Certifikimi i Qendrueshmerise Mjedisore per Ushqimin dhe Industrine Kimike



### Çfare eshte?

ISCC PLUS, eshte skema e vendosur nga ISCC (International Sustainability & Carbon Certification) qe mbulon ushqimin per njerez e per kafshe dhe aplikimet per produkte teknike e kimike.

Kjo mund te perdoret ne te gjitha boten per te deshmuar perdorimin e qendrueshem te biomases dhe/ose riciklimit nga mbetjet e paketimit ne industrine kimike dhe gjithashtu ne sektoret e ndryshem industrial (p.sh. industria e paketimit).

ISCC PLUS gjithashtu konsideron qendrueshmerine mjedisore ne te gjitha fazat e zinxhireve te furnizimit dhe prodhimit ne industrite ushqimore.

*REDcert2 dhe ISCC PLUS – Certifikimi i qendrueshmerise mjedisore per industrine kimike dhe sektorin ushqimor.*

Sistemi i certifikimit ISCC, i themeluar nga shoqatat dhe organizatat kryesore te ekonomise



bujqesore dhe biokarburanteve ka reaguar gjithashtu ndaj nevojës ne rritje per certifikime te qendrueshmerise mjedisore.

REDcert<sup>2</sup> dhe ISCC EU tani njihet ne te gjitha BE-ne si nje sistem certifikimi per perdorimin e qendrueshem te biomases. Fale ketij certifikimi, kompanite ne industrine kimike si dhe prodhuesit e ushqimit dhe ushqimit te kafsheve, mund te ofrojne deshmi te zevendesimit te burimeve me baze fosile ne biomase te qendrueshme mjedisore ne produktet e tyre perfundimtare.

***TÜV NORD CERT eshte miratuar dhe regjistruar si nje organ certifikimi nga ISCC dhe REDcert dhe gjithashtu per ISCC EU, ISCC PLUS dhe REDcert2.***

### ASPEKTE LIGJORE!

Aplikimi i direktives EU Red II (EU 2018/2001) ne Shqiperi eshte nje nga objektivat e Qeverise ne Sesionet e Parlamentit 2021-2023 si shtese per Ligjin LIGJ Nr. 7/2017 PËR NXITJEN E PËRDORIMIT TË ENERGISË NGA BURIMET E RINOVUESHME i cili aplikon direktiven EU RED 1.

Standardet kryesore ne fushen e biokarburanteve te qendrueshme jane ISCC EU dhe REDcert EU..Keto jane ne treg prej me shume se dhjete vitesh. Standardet ISCC-PLUS dhe REDcert2, zbaton te njejtat parime ne te gjitha fushat e tjera te ekonomise qarkulluese.

## Perse duhet Certifikimi ISCC PLUS dhe REDcert2 ?

- Certifikimi ISCC-PLUS dhe REDcert2 bejne te mundur plotesimin e kerkesave per qendrueshmeri mjedisore. Lendet e para dhe produktet me certifikim te qendrueshmerise mund te arrijne vlera me te larta ne treg.
- Qendrueshmeria mjedisore ne industrine e plastikes dhe ne industrite kimike dhe teknike.
- Certifikimi identifikon kompanine si First Mover ne kete sektor duke i dhene edhe prestigj, pasi sipas komunikimeve te BE-se mbi temen e plastikes. Ai do te jete i detyrueshem ne te ardhmen.
- Zevendesimi i lendeve te para me baze fosile ndihmon ne mbrojtjen e mjedisit

Rep.Albania

Elvis Pazaj

Am TÜV NORD

1005 Tirana,

Albania

M +355 (0)692031015

F +355 (0)445 31015

E [epazaj@tuev-nord.de/](mailto:epazaj@tuev-nord.de/)

[epazaj@tuv-nord.com](mailto:epazaj@tuv-nord.com)

## Certifikimi me TUV NORD

TÜV NORD njihet si nje ofruer i mirefillte dhe i besueshem i sherbimeve te inspektimit dhe certifikimit, duke vleresuar permbushjen e rregulloreve ligjore dhe standardeve vullnetare ne te gjitha boten. Ne punesojme specialiste me pervojte ne te gjitha fushat e veprimtarise sone. Si parim, auditoret tane jane te trajnuar ne nje nivel shume te larte dhe perdorin metoda te standardizuara. Kjo do te thote qe ne mund te garantojme neutralitet dhe vazhdimesi ne te gjitha sherbimet tona per ju.